


JU JENI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS




Këtu ju mund të gjeni informata për Azil-kërkues në Kosovë



Kush është refugjat?

Një person i cili për shkak të **frikës së bazuar të persekutimit** për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, është jashtë vendit të shtetësisë së tij dhe **nuk ka mundësi ose për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron të përfitoj nga mbrojtja e atij shteti**, ose i cili, duke mos pasur shtetësi dhe duke qenë jashtë vendit të banimit të tij të mëparshëm, si rezultat i ngjarjeve të tilla, nuk është në gjendje ose për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron të kthehet në të.



A keni përjetuar frikë ose keqtrajtim të tillë për një ose më shumë nga këto arsye?

Nëse po, e ju jeni shtetas i huaj ose person pa shtetësi, ju mund të paraqitni kërkesë për azil. Ju do të bëheni **azil-kërkues**.

Ku dhe kur ju mund të kërkonti azil?

Ju mund të paraqitni kërkesën tuaj për azil në momentin e hyrjes në Kosovë:

Ju mund ta bëni këtë:

- në pikën e kufirit kufitar;

- në një stacion policor;

- në Departamentin për Shtetësi Azil dhe Migracion (DSHAM).



Ju keni të drejtë të kërkonti azil në gjuhën të cilën ju e kuptoni.

Çfarë do të ndodh pasi ju kërkonti azil? Kush është përgjegjës?

Të dy palët, Policia dhe Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, janë përgjegjës për pranimin e kërkesës tuaj, plotësimin e një formulari fillestar, marrjen e shenjave të gishtërinjve, fotografive, dokumenteve të udhëtimit dhe dëshmime të tjera në lidhje me kërkesën tuaj për azil.



DSHAM do të ju intervistoj sa më shpejt që të jetë e mundur. Ju jeni të detyruar të deklaroni të gjitha faktet dhe rrethanat që mbështesin kërkesën tuaj për azil, të deklaroni të vërtetën në të gjitha përgjigjet, të paraqitni të gjitha provat në dispozicion dhe të jepni shpjegim bindës dhe të besueshëm.

Cilat janë të drejtat tuaja?

Ju keni të drejtë:

- Të kontaktoni Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe/ose ndonjë nga Organizatat jo-qeveritare të cilat ofrojnë ndihmë për azil kërkues;

- Të banoni në Republikën e Kosovës, derisa të merret vendimi përfundimtar;

- Në liri të mendimit dhe besimit fetar;

- Në kushte themelore të jetesës;

- Në shërbim shëndetësor;

- Në asistencë sociale;

- Në ndihmë juridike falas;

- Në shkollim për fëmijët;

- Në punësim dhe trajnim profesional.



Kë mund të kontaktoni?

Ministria e Punëve të Brendshme

Zyra për marrëdhënie me jashtë
Tel: + 383 (0)38 200 19 545
Email: zip-mpb@rks-gov.net
Rr. Luan Haradinaj
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Ndihmë Ligjore

Civil Rights Program – Kosovo (CRP/K)
Tel: + 383 (0)38 243 610/611
Email: crp@crpkosovo.org
Rr. Lorenc Antoni nr. 15
Qyteza Pejton
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Web: www.crpkosovo.org

CRP/K është Organizatë Joqeveritare, partnere e UNHCR-së.



REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF
INTERNAL AFFAIRS




CRP/K
PROGRAMI PËR TË DREJTAT CIVILE KOSOVË
CIVIL RIGHTS PROGRAM KOSOVO
PROGRAM GRADANSKIH PRAVA KOSOVA

Ku do të strehoheni ju?

Ju mund të strehoheni në Qendrën për Azilkerkuesit ose në një vend tjetër të caktuar nga DSHAM.

Nëse keni nevoja të veçanta do të ju ofrohet standardi jetësor në përputhje me nevojat tuaja specifike.



Azili në Kosovë është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ajo është e rregulluar me Ligjin për azil (Ligji Nr. 06/L-026) i cili është i harmonizuar me Konventën e Gjenevës të vitit 1951. DSHAM është përgjegjës për marrjen e vendimeve në shkallë të parë.

Cilat janë obligimet tuaja?

- Gjatë gjithë kohës të veproni në pajtim me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të Republikës së Kosovës, si dhe me masat e ndërmarra nga organet shtetërore;

- Të bashkëpunoni me DSHAM dhe organet e tjera relevante qeveritare;

- T'i përgjigjet ftesave të organit kompetent dhe zyrave të tjera qeveritare dhe të bashkëpunoni në çdo fazë të procedurës së azilit;

- T'i dorëzoni dokumentet e udhëtimit, identitetit dhe dëshmitë tjera që i keni në dispozicion; të bashkëpunoni me organin kompetent lidhur me marrjen e gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografisë;

- Ta njoftoni DSHAM për çfarëdo ndryshimi të adresës brenda tri (3) ditësh;

- Të veproni në pajtim me urdhrat që lëshohen nga organi kompetent dhe me të gjitha urdhrat tjera qeveritare lidhur me kufizimet e lëvizjes;

- Të mos lëshoni territorin e Kosovës pa lejen e organit kompetent, derisa të mos përfundohet procedura e azilit.



Kur mund të pezullohet procedura e azilit?

- Nëse e tërhiqni kërkesën për azil;

- Nëse ju jeni larguar nga vendi i fundit i banimit për më shumë se 3 ditë pa e informuar autoritetin kompetent, me përjashtim të rasteve kur brenda një kohe të arsyeshme ju mund të vërtetoni që kjo ka ndodhur për shkak të rrethanave jashtë kontrollit tuaj;

- Nëse ju largoheni nga Republika e Kosovës gjatë zhvillimit të procedurës.

Çfarë ndodhë nëse kërkesa juaj refuzohet?

Në këtë rast, ju keni të drejtë për të paraqitni ankesë në Komitetin Kombëtar për Refugjatë (shkalla e dytë) kundër vendimit të marrë në shkallë të parë. Ju do të jeni i autorizuar të qëndroni në Republikën e Kosovës deri në një vendim përfundimtar.